

3. KRITERI POLITIK

- **Progresi në kriterin politik, duke u fokusuar në prioritetet kyçe të Opinionit të Komisionit, veçanërisht:**

- **Lufta kundër Korrupsionit**

a) **Hartimi i Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit 2014 -2017;**

b) Rrjeti i koordinatorëve dhe pikat e kontaktit anti-korrupsion si në institucionet e pavarura dhe ekzekutive (përfshirë nivelin lokal).

Në lidhje me statistikat e harmonizuara nga Track Recordi për rastet e korrupsionit, grupi i punës i kryesuar nga Ministria e Drejtësisë ka harmonizuar të dhënat për 3 mujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2013, si dhe ka harmonizuar të dhënat për gjithë vitin 2013.

Për këtë qëllim, gjatë vitit 2014, theksi do të vihet në krijimin e një baze të dhënash elektronike, si edhe analiza e statistikave dhe e të dhënave të krijuara për çdo periudhë 3 mujore. Procesi i ngritjes së një databaze elektronike, do të udhëhiqet nga Koordinatori Kombëtar për Anti-korrupsionin (NCAC).

VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT TË HETUARA

Gjatë periudhës 16 shtator 2013 deri më 27 shkurt 2014, nga ana e strukturave për korrupsionin janë evidentuar 287 vepra penale, nga të cilat 282 të zbuluara, me 466 autorë të dyshuar, 84 prej të cilëve të arrestuar/ndaluar, 377 proceduar në gjendje të lirë dhe 5 në kërkim.

Gjatë periudhës 16 shtator 2012 deri më 28 shkurt 2013, nga ana e strukturave për korrupsionin janë evidentuar 172 vepra penale, 171 të zbuluara, me 252 autorë të dyshuar, 30 prej të cilëve të arrestuar/ndaluar, 229 proceduar në gjendje të lirë dhe 3 në kërkim.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, janë evidentuar 115 vepra penale më shumë, janë proceduar penalisht 214 autorë më shumë dhe janë arrestuar/ndaluar 54 autorë më shumë.


Në veprat e korrupsionit dhe zyrtarëve në detyrë, **ka një rritje të evidentimit dhe goditjes së tyre**. Po aplikohen gjithmonë e më shumë metodat speciale të hetimit (pothuajse të gjitha veprat e korrupsionit janë hetuar me këto metoda). Përveç fushave të tjera si arsimi, shëndetësia, tatime etj., gjatë vitit 2013, është punuar në drejtim të goditjes së korrupsionit në sistemin e drejtësisë. (Vlen të përmendet rasti i arrestimit të një gjyqtari, një prokurori dhe punonjësve të tjerë të sistemit të drejtësisë).

Objektivat në këtë fushë kanë qenë:

- Rritja me 5% e evidentimit të rasteve të korrupsionit dhe krimeve të zyrtarëve në detyrë.
- Rritja me 5% e evidentimit të rasteve të korrupsionit.
- Rritja me 5% e hetimeve proaktive për korrupsionin.

- Kritja me 5% e operacioneve policore për korrupsion dhe krime të zyrtarëve në detyrë, duke përdorur teknikat speciale të hetimit.
- Të gjitha këto objektiva janë realizuar dhe tejkaluar gjatë vitit 2013.

Korrupsion dhe krime të zyrtarëve në detyrë



Gjatë periudhës 16 shtator 2013 deri më 27 shkurt 2014 janë finalizuar 22 operacione policore me 67 autorë, prej të cilëve 53 janë arrestuar/ndaluar.

Gjatë periudhës 16 shtator 2012 deri më 28 shkurt 2013 janë finalizuar 15 operacione policore me 43 autorë, prej të cilëve 36 janë arrestuar. Finalizimi me sukses i këtyre operacioneve rezulton se 14 prej tyre janë hetuar me metoda speciale të hetimit.

Në krahasim me periudhën 16 shtator 2012 deri më 28 shkurt 2013, janë finalizuar 7 operacione policore më shumë, 6 operacione policore me teknika më shumë dhe janë goditur 24 autorë më shumë dhe janë arrestuar/ndaluar 17 autorë më shumë.

Gjatë periudhës 16 shtator 2013 deri më 27 shkurt 2014, janë goditur 12 grupe kriminale, gjithsej 56 autorë, nga të cilët 45 të arrestuar/ndaluar.

Gjatë periudhës 16 shtator 2012 deri më 28 shkurt 2013, janë goditur 5 grupe me 22 autorë, nga të cilët 16 të arrestuar/ndaluar.

Në krahasim me periudhën 16 shtator 2012 deri më 31 janar 2013, janë goditur 7 grupe më shumë me 34 autorë më shumë, me 29 të arrestuar më shumë.

Reformimi i SHKB-së mbi bazën e konceptit të mbikëqyrjes qytetare ka për qëllim kombimin e një përqasjeje “reaktive” – në luftën kundër korrupsionit me një zgjidhje “proaktive” për të trajtuar shkaqet e korrupsionit dhe sjelljes së pahijshme. Përqasja “reaktive” mundësohet nga trajtimi dhe shqyrtimi i ankesave të bëra nga qytetarët ndaj punonjësve të policisë për sjellje joetike, mosushtrim dhe abuzim me detyrën, kryerje të veprimtarisë korruptive etj. Nga ana tjetër e medaljes, përqasja proaktive mundësohet nëpërmjet grumbullimit dhe analizimit të informacionit kriminal, inspektimit për tematika dhe fusha të menaxhimit, operimit dhe organizimit policor dhe vlerësimit të nivelit të përputhshmërisë me ligjin dhe procedurat.

Konkretisht ka nisur reformimi ligjor dhe më pas ai organizativo-strukturor dhe funksional për të pasur një efikasitet dhe efikasitet më të lartë në parandalimin dhe luftën kundër korrupsioni. Grupi i punës së SHKB-së në bashkëpunim të ngushtë me partnerët si PAMECA – IV dhe veçanërisht ICITAP, por dhe ekspertë të fushës nga struktura brenda dhe jashtë Ministrisë së Punëve të Brendshme, kanë hartuar dhe janë në fazë përfundimi të projektligjit të ri, i cili synon shndërrimin e shërbimit në një shërbim më civil, larg influencës së strukturave që ajo mbikëqyr dhe kontrollon.

Të dhënat e kallëzimeve penale dhe tabela krahasimore për vitet 2013 dhe 2012 si më poshtë:

Vitet	Nr. çështjeve penale	Nr. subjekteve	Sipas niveleve					Arrestuar në flagrancë
			I lartë	Mesëm drejtues	Parë drejtues	Zbatues	Punonjës civilë	
2012	105	132	-	1	50	77	4	19
2013	134	170	1	4	63	88	14	23

vitet	2012	2013	% krahasimore
Nr. çështjeve penale	105	134	21 % rritje
Nr. subjekteve	132	170	23 % rritje

Së dyti, veprimtaria inspektuese që ka si qëllim të evidentojë si dhe sa e kanë kryer detyrën e tyre funksionale strukturat që ato inspektojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret që normojnë veprimtarinë e tyre.

Gjatë periudhës raportuese, nga strukturat e inspektimit të shërbimit, mbi bazën e planit vjetor të inspektimeve janë kryer 14 inspektime të zakonshme si dhe 9 inspektime jashtë radhe. Si rezultat i këtyre inspektimeve është arritur që në:

- 8 raste për 23 punonjës policie produkti i përfituar nga inspektimi është përdorur si material kallëzues për fillimin e hetimit penal (referim në prokurori);
- 8 raste për 50 punonjës policie produkti i raporteve të inspektimit ka shërbyer si bazë për fillimin e ecursë disiplinore nga strukturat e Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Së treti, trajnimi i vazhdueshëm i personelit hetues dhe inspektues të SHKB-së, me qëllim rritjen e performancës në punë dhe përmbushjes së detyrave funksionale.

Gjatë **vitit 2013** janë realizuar:

- 5 trajnime për personelin hetues të shërbimit, organizuar nga ICITAP, OSBE, dhe PAMECA – IV, EPAC dhe BE (Slloveni);

- 1 workshop, organizuar nga OPDAT;
- 1 konferencë rajonale, organizuar nga DCAF dhe OSCE (Maqedoni).

Gjatë vitit 2012 janë realizuar:

- 6 trajnime, nga ICITAP në Shqipëri dhe Kosovë.

Së fundmi, rritja e integritetit dhe përmirësimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm për parandalimin e shkeljeve administrative dhe ligjore brenda shërbimit, nëpërmjet zbatueshmërisë ligjore të ligjit Nr. 10002, datë 06.10.2008, për “Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si Rregullorja e Personelit, Rregullorja e Disiplinës dhe Rregullorja e Brendshme e SHKB-së. Si rezultat i funksionimit të këtyre mekanizmave, është bërë e mundur:

- Dhënia e 13 masa disiplinore për performancë në nivele tepër të ulëta në kryerjen e detyrës funksionale, deri në “përgjashtim nga shërbimi”, bazuar tek një proces disiplinor i hapur dhe i drejtë për personelin hetues, inspektues dhe mbështetës të shërbimit.

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, gjatë periudhës tetor 2013 – shkurt 2014, ka dërguar pranë organit të Prokurorisë 50 kallëzime penale për 56 punonjës policie, prej të cilëve 1 punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues, 25 punonjës të nivelit të parë drejtues, 26 punonjës të nivelit zbatues, 4 punonjës civilë dhe 7 shtetas.

Nga totali i çështjeve penale të referuara, për vepra korruptive janë referuar 35 materiale kallëzuese, për 43 punonjës policie, nga të cilët, 1 punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues, 19 punonjës të nivelit të parë drejtues, 18 punonjës të nivelit zbatues, 5 punonjës civilë dhe 5 shtetas. Arrestuar në flagrancë 9 punonjës policie ku 1 punonjës i nivelit të mesëm drejtues, 4 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 3 punonjës policie niveli zbatues, 1 punonjës civil dhe 5 shtetas.

Pjesëmarrja në trajnime, seminare dhe workshop-e e 18 punonjësve të shërbimit, me tematika të larmishme duke filluar nga:

- Seminari teknik me temë “Përdorimi i teknikave të avancuara të informacionit: Perspektiva e Agjencive Anti-Korrupsion”, nga data 28 – 29 Tetor, në Ljubjanë të Sllovenisë, organizuar nga EPAC dhe DPPB e BE-së.
- Konferenca Rajonale e Njësive të Kontrollit të Brendshëm, me temë “Integriteti Policor dhe Mbikëqyrja Policore”, zhvilluar në Shkup të Maqedonisë, nga data 5 – 7 nëntor 2013, organizuar nga OSBE-ja dhe DCAF.
- Trajnimi bazë i hetimit për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, nga data 17 – 19 shkurt 2014, organizuar nga PAMECA IV, në Qendrën e Formimit Policor.

Përmirësimi i sistemit dhe mekanizmeve të trajtimit dhe shqyrtimit të ankesave të qytetarëve për rastet e denoncimit të korrupsionit dhe shkeljeve të tjera nga punonjës të Policisë së Shtetit.

- Prodhimi dhe shpërndarja e posterave (rreth 200 copë) në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar, pranë Komisariateve dhe Drejtorive të Policisë në Qarqe si dhe pranë Njësive Bashkiake dhe Komunave kryesore në vend, ku ftohen qytetarët që për çdo ankesë ndaj punonjësve të Policisë apo informacion në kuadër të forcimit të sigurisë e rendit publik, të telefonojnë në linjën pa pagesë 0800 90 90 ose në e-mail: shkb@moi.gov.al.
- Gjatë periudhës analizuese janë trajtuar dhe shqyrtuar 173 ankesa, ku për 21 raste është sugjeruar fillimi i ecuresë disiplinore nga strukturat e Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në 6 raste është bërë referimi i çështjes pranë organit të Prokurorisë.

6. IMPLEMENTIMI I MARRËVESHJES SË STABILIZIM -ASOCIIMIT

6.1 Drejtësia, Liria dhe Siguria

- **Monitorimi i Procesit të Liberalizimit të Vizave**

Monitorimi i lëvizjes pa viza i shtetasve shqiptarë në drejtim të vendeve BE/Schengen ka qenë një nga mekanizmat kryesore, mbi të cilat është mbështetur Policia Kufitare dhe e Migracionit, për të reduktuar fenomenet negative që lidhen me të dhe sidomos ato të azilkërkimit dhe tejkalimit të afatit të qëndrimit në këtë hapësirë.

Autoritetet policore kufitare dhe të migracionit, kanë monitoruar në vazhdimësi procesin e liberalizimit të vizave, monitorim i cili ka konsistuar kryesisht në nënshkrimin e Marrëveshjeve dhe Memorandumit të Mirëkuptimit për shkëmbimin e informacionit mbi çështjet e azilit dhe migrimit me Austrinë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Gjithashtu, në kuadrin e bashkëpunimit me vendet e BE-së dhe konkretisht, me Belgjikën dhe Francën, janë organizuar dy operacione të riatdhesismit të shtetasve shqiptarë, që kishin shkelur rregullat e qëndrimit në hapësirën Schengen.

Gjatë vitit 2013, kanë udhëtuar nga Shqipëria në drejtim të vendeve të BE-së/Schengen 3.797.958 shtetas dhe u është refuzuar hyrja në këto vende vetëm 11.946 shtetasve. Ndërsa gjatë vitit 2012, kanë udhëtuar në drejtim të vendeve të BE-së/Schengen 3.959.730 shtetas shqiptarë dhe u është refuzuar hyrja në këto vende vetëm 12.067 shtetasve.

	Viti 2012	Viti 2013	Diferenca në%
Dalje nga Shqipëria	3.959.730	3.797.958	- 4%
Refuzim hyrjeje në BE	12.067	11.946	- 1%

Në tabelën në vijim, paraqiten statistikën e daljes së shtetasve shqiptarë dhe refuzimit të hyrjes së tyre në hapësirën BE/Schengen për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2012, krahasuar me periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2013, ku siç vihet re rezulton se numri i udhëtarëve është pothuajse i njëjtë ndërsa refuzimet e daljes janë rritur me rreth 10%.

	3 Mujori i katërt Viti 2012	3 Mujori i katërt Viti 2013	Diferenca në %
Dalje nga Shqipëria	849.823	848.714	-0.1%
Refuzim hyrjeje në BE	1.805	2.002	+10%

Për sa i përket numrit të shtetasve shqiptarë të larguar nga vendet e BE/Schengen, rezulton se gjatë vitit 2013, numri i të kthyerve nga vendet e BE-së dhe ripranuar nga Shqipëria, ka qenë 15.289 shtetas, ndërsa gjatë vitit 2012 numri i shtetasve të kthyer/ripranuar ka qenë 9.450 shtetas.

	Viti 2012	Viti 2013	Diferenca në %
Të ripranuar	9.450	15.289	+38%

Krahasimi për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2012, me të njëjtën periudhë të vitit 2013, paraqitet në tabelën në vijim.


	3 Mujori i katërt Viti 2012	3 Mujori i katërt Viti 2013	Diferenca në%
Të ripranuar	3.653	5.751	36%

Në zbatim të procedurave standarde dhe në kuadrin e monitorimit të liberalizimit të vizave dhe abuzimit me kërkesat për azil, gjatë vitit 2013, nga Policia Kufitare dhe Migracionit në PKK-të, janë bërë 7.308 refuzime në dalje të shtetasve shqiptarë, ku 3.315 shtetasve u është refuzuar dalja për arsyen se këta shtetas kanë qenë më parë të larguar nga vendet BE/Schengen dhe kanë ndalim hyrjeje në këtë territor.


Gjithashtu, lidhur me masat e marra nga Policia Kufitare dhe Migracionit për evidentimin e shtetasve shqiptarë të cilët kërkojnë të ndërrojnë gjeneralitetet, për të evituar refuzimin e hyrjes në vendet Schengen, si pasojë e urdhrave për ndalim hyrjeje në këtë hapësirë, rezulton se gjatë vitit 2013 janë bërë 2.870 kërkesa për ndërrimin e gjeneraliteteve, ku 2.141 shtetas kanë rezultuar të rregullt, ndërsa 734 ose 25% e shtetasve që kanë kërkuar të ndërrojnë gjeneralitetet kanë rezultuar të kthyer deportive, Inad ose me të dyja masat së bashku. Numri i kërkesave për ndërrimin e emrit ka shkuar në ulje, pasi gjatë muajit janar 2013 këto kërkesa kanë qenë 571, ndërkohë që në muajin dhjetor 2013 numri i kërkesave është ulur deri në 33.

- Monitorimi i azilkërkimit nga shtetas shqiptarë në hapësirën e vendeve të BE/Schengen mbështetur në të dhënat e Eurostat¹

Në një vështrim krahasimor vërejmë se numri më i madh i shtetasve shqiptarë që kanë kërkuar azil gjatë vitit 2013, rezulton të jetë më i lartë se në vitin 2012.



Gjatë vitit 2013, azilkerkuesit janë evidentuar kryesisht në Francë, në Britaninë e Madhe dhe po ashtu është vërejtur një rritje konstante e azilkerkuesve edhe në Gjermani.



- Fushata Informuese

Kanë pasur një pasqyrim të gjerë në median elektronike dhe atë të shkruar vizitat e disa ambasadorëve të vendeve të BE/Schengen në Pikat e Kalimit Kufitar, në të cilat janë pasqyruar kthimet në Shqipëri të shtetasve shqiptarë që kanë abuzuar me liberalizimin e vizave.

¹ Për disa shtete nuk paraqiten të dhënat e muajit Dhjetor 2013

Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Integrimit Evropian kanë zbatuar një kalendar të aktiviteteve në të gjitha shkollat e mesme dhe institucionet e arsimit të lartë me temë "Si të njohë Evropën", i cili është përhapur në të gjithë vendin duke përfshirë të gjitha shkollat dhe komunitetet.

- **Ndjekja e çështjeve të mëposhtme të Nën-Komitetit prill 2013, duke u fokusuar në veçanti në prioritetet kyçe të Opinionit të Komisionit:**

LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

- Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë këtij viti, në kuadër të projektit ILECU, ka vijuar të funksionojë rrjeti i Shefave të ILECU-t. Po në këtë kuadër, ka përfunduar edhe Manuali i Bashkëpunimit Rajonal për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore.

Gjatë kësaj periudhe, janë nënshkruar, kanë hyrë në fuqi, dhe janë implementuar marrëveshjet, protokollet ose memorandumet e poshtëshënuara:

1. "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Austriake mbi shkëmbimin e ndërsjelltë të të dhënave për çështjet e kontrollit të migracionit dhe për çështjet e azilit", nënshkruar në Vjenë, Austri më datë 29 janar 2013.
2. VKM Nr. 69, datë 23.01.2013, "Për miratimin në parim, të ndryshimit të Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëpunimin dhe Mbështetjen e Sekretariatit të Konventës së Bashkëpunimit Policor të Europës Juglindore".
3. VKM Nr. 70, datë 23.01.2013, "Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar, Trebisht-Xhepish".
4. VKM Nr. 112, datë 13.2.2013, "Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë, për Programin e Policimit në Komunitet".
5. Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Institutit Evropian të Tiranës, "Për respektimin e trajtimit dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit", Nr. 27, datë 25.03.2013.
6. Memorandum Mirëkuptimi, Nr. 1220/5, datë 09.04.2013, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme që operon nëpërmjet Agjencisë së Kufirit të Mbretërisë së Bashkuar për shkëmbimin e informacionit për qëllime që lidhen me migracionin, nënshkruar në Tiranë më 13 mars 2013.
7. Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, "Për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, mbi ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm", nënshkruar më 14 prill 2005 në Luksemburg dhe nënshkruar në Tiranë në datë 08.04.2013.

8. Hyrja në fuqi më 5 mars 2013 e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar, Trebisht - Xhepisht”, nënshkruar në Tiranë në datë 23 nëntor 2012.
9. Marrëveshja dhe Protokoli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Ndërkufitar, Borje (Kukës) - Gllaboçice (Dragash), nënshkruar në muajin prill 2013. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që edhe në këtë PKK të aplikohet mënyra e punës si në PPKK Muriqan - Sukobinë, miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.
10. Marrëveshja dhe Protokoli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar, Orgjost (Kukës)-Orçush (Dragash), nënshkruar në muajin prill 2013. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që edhe në këtë PKK të aplikohet mënyra e punës si në PPKK Muriqan -Sukobinë, miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.
11. Marrëveshja dhe Protokoli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Ndërkufitar, Shishtavec (Kukës) - Krusheve (Dragash), nënshkruar në muajin prill 2013. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që edhe në këtë PKK të aplikohet mënyra e punës si në PPKK Muriqan - Sukobinë, miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.
12. Marrëveshja për ngritjen e Qendrës së Përbashkët të Bashkëpunimit Policor në Morinë-Vermicë me Kosovën. Kjo marrëveshje është në kuadër të zbatimit të kërkesave të Konventës së Vjenës, dhe ka të bëjë me krijimin e qendrave të përbashkëta të Bashkëpunimit Policor ndërmjet vendeve, me qëllim lehtësimin e rrugëve të shkëmbimit të informacionit, nënshkruar në muajin prill 2013.
13. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Maqedonisë, mbi bashkëpunimin në fushën e kontrollit të brendshëm, nënshkruar në Pikën e Kalimit Kufitar Qafë Thanë, në 17 maj 2013.
14. Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Formimit Policor të Policisë së Shtetit dhe Kolegjit Policor European, CEPOL, në muajin maj 2013.
15. Marrëveshja e Bashkëpunimit në fushën e sigurisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, nënshkruar në datë 18.06.2013.
16. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, nënshkruar në Bukuresht, në datë 18.10.2013.
17. Marrëveshja mbi bashkëpunimin operacional dhe strategjik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol), e cila është nënshkruar në 9 dhjetor 2013, në Hagë.

Ndërsa në vitin 2012, është iniciuar fillimi i negociatave për nënshkrimin e 9 marrëveshjeve apo protokolleve të bashkëpunimit:

- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për përcaktimin e Pikës së Përbashkët të

Kalimit Kufitar, Zatrijebacka - Cijevna-Grabon, për trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve, dhe për pikën e kalimit kufitar “Cerem-Vranica”.

- Protokolli “Për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë për ripranimin e personave”.
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, “Për luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe terrorizmit ndërkombëtar”, ka hyrë në fuqi në datë 01.03.2012.
- Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë “Për krijimin dhe funksionimin e një Qendre të Përbashkët Bashkëpunimi Policor”.
- Marrëveshja për ndryshimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë mbi lëvizjen e ndërsjelltë të shtetasve”, që parashikon lëvizjen me karta identiteti.
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për mbrojtjen e ndërsjelltë të informacionit të klasifikuar.
- Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke, “Për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.
- Protokolli i Bashkëpunimit gjatë Sezonit Turistik 2012, ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Policisë së Kosovës, nënshkruar në datë 22.06.2012.
- Protokolli i Bashkëpunimit gjatë Sezonit Turistik 2012, ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Policisë së Malit të Zi, nënshkruar në datë 25.06.2012.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitin 2013, Sektori i Oficerëve Ndërlidhës, ka shkëmbyer 2.517 informacione për ngjarje kriminale për arrestimin apo vendndodhjen e personave në kërkim ndërkombëtar. Ndërsa në vitin 2012, numri i informacioneve të shkëmbyera ka qenë 1.636, të cilat i referohen ngjarjeve kriminale të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të shtetasve shqiptarë të arrestuar ose ndaluar, si dhe informacione për personat e kërkuar.

Numri i informacioneve të shkëmbyera gjatë këtij viti nga Zyra Kombëtare EUROPOL është 421, ndërsa për vitin 2012, ky numër ka qenë 278.

Janë kryer veprime të përbashkëta për Letër - Porosi, operacione të përbashkëta policore etj., si Operacioni Sottotraccia, Ellenika, IPO Europe. Në datat 26, 27 dhe 28 shtator 2013, u zhvillua një ‘Operacion i Përbashkët Policor (JPO) Europa 2013, i drejtuar nga shteti italian, me mbështetjen e Europol-it, si dhe të autoriteteve të zbatimit të ligjit nga Shqipëria, Austria, Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Gjermania, Hungaria, Italia, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Rumania, Serbia, Sllovenia dhe Mbretëria e Bashkuar. Gjithashtu, në operacion morën pjesë EULEX, Eurojust, Frontex dhe Interpol.

Shenjestra e operacionit të përbashkët policor ishin automjetet e vjedhura në BE dhe të kontrabanduara drejt lindjes.

a) Operacionet Ndërkombëtare

Gjatë segmentit kohor janar – dhjetor 2013 janë realizuar 7 operacione në bashkëpunim me shërbimet policore homologe të vendeve të rajonit dhe të BE-së, ndër të cilat:

- 2 operacione të kryera në bashkëpunim me Qendrën SELEC, ku janë identifikuar si të implikuar 9 shtetas, të cilët janë proceduar në gjendje të lirë, (1 operacion për veprën penale të “Trafikimit të mjeteve motorike” dhe 1 për veprën penale “Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.
- 2 operacione të kryera në bashkëpunim me homologët policorë të Italisë, për goditjen e shfrytëzimit në rrethana rënduese dhe trafikimit të femrave. Janë arrestuar 2 shtetas të implikuar.
- 1 operacion i kryer në bashkëpunim me homologët policorë të Gjermanisë dhe Zvicrës, në të cilin janë implikuar 3 shtetas shqiptarë, të arrestuar.
- 1 operacion i kryer në bashkëpunim me policinë angleze, me agjencinë SOCA, në të cilin janë evidentuar 5 autorë nga të cilët 3 janë arrestuar dhe 2 janë shpallur në kërkim.
- 1 operacion i realizuar në bashkëpunim me EUROPOL-in, EUROJUST-in, FRONTEX-in dhe INTERPOL-in, në drejtim të goditjes së “Trafikimit të mjeteve motorike”, ku janë implikuar 24 autorë, të cilët procedohen në gjendje të lirë.

Gjatë vitit 2013, janë goditur 7 grupe kriminale, janë implikuar si pjesë e këtyre grupeve kriminale 28 shtetas, nga të cilët 22 janë arrestuar/ndaluar, 1 procedohet në gjendje të lirë dhe 5 janë shpallur në kërkim. Krahasuar me vitin 2012, janë goditur 2 grupe më pak. Gjithashtu, kemi një rënie të numrit të personave të identifikuar si pjesë e këtyre grupeve kriminale me 16 persona më pak.

• Lufta kundër Narkotikëve

Treguesit kundër narkotikëve për periudhën 16 shtator 2013 – 27 shkurt 2014:

	2013	2012
Shtetas shqiptarë/të huaj të arrestuar jashtë vendit, të kërkuar nga autoritetet shqiptare të drejtësisë - arrestime DKJ.	95	66
Shtetas shqiptarë/të huaj (të kërkuar nga autoritetet shqiptare të drejtësisë) të ekstraduar nga jashtë vendit drejt Shqipërisë - ekstradime DKJ.	49	71
Të arrestuar shtetas shqiptarë/të huaj, të kërkuar në nivel ndërkombëtar nga zyra homologe - arrestime FKB dhe DKB.	117	113
Shtetas shqiptarë/të huaj (të kërkuar nga autoritetet e huaja të drejtësisë) të ekstraduar nga Shqipëria drejt vendeve të tjera - ekstradime DKB dhe FKB.	73	78

Gjatë vitit 2013, në kuadër të një projekti të UNODC-së dhe Qeverisë Shqiptare, i mbështetur nga donatorë të huaj, është ngritur njësi e përbashkët për kontrollin e kontejnerëve në Portin e Durrësit (2 specialistë nga Seksioni Antidrogë, 2 nga Policia Kufitare dhe 2 nga Dogana) dhe vazhdon trajnimi i stafit brenda dhe jashtë vendit. Inaugurimi i rikonstruksionit të ambienteve ku është vendosur njësi, u krye më datë 11.02.2013. Aktualisht, po punohet për miratimin e procedurave standarde të punës së kësaj njësie të përbashkët.

Analizimi i informacioneve dhe intensifikimi i punës për goditjen e rrjeteve të trafikut e shpërndarjes së drogave, në bashkëpunim me Prokurorinë dhe partnerët ndërkombëtarë;

Gjatë vitit 2013, në përgjithësi, të gjithë treguesit për luftën kundër drogës kanë pasur qëndrueshmëri krahasuar me një vit më parë. Trafiku i marijuanës ka qenë problemi më kryesor gjatë këtij viti ku ka pasur një rritje të numrit të rasteve. Vendet kryesore të destinacionit kanë qenë Greqia dhe Italia dhe më pak vende të tjera të rajonit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi etj., të cilat në disa raste përdoren edhe si vende tranzit për destinacione të tjera në vendet e Evropës Perëndimore. Po kështu, vihet re një rritje e lehtë e rasteve të kokainës dhe heroinës.

Tabela statistikore për veprat penale dhe autorët e proceduar penalisht, si dhe sasi të drogave të sekuestruara për periudhën 16 shtator 2013 – 31 janar 2014.

Lloji	Nr.Raste	Zbuluar	Sasia	Autorë	Arr/Ndal	Gj.Lirë	Kërkim
Heroinë	46	46	22 kg 553.5 gr	55	48	6	1
Metadon	2	2	137.3 gr	2	1	1	0
Kokainë	30	30	14 kg 276.9 gr	32	28	4	0
Marijuanë	561	522	15483 kg 606.5 gr	667	383	259	25
Hashish	3	3	8 kg 837.4 gr	5	5	0	0
Fara Kanabis	3	3	486.3 gr	4	4	0	0
Përzierës	2	2	84.1 gr	2	2	0	0
Totali	647	608		767	471	270	26

Tabela statistikore për veprat penale dhe autorët e proceduar penalisht, si dhe sasi të drogave të sekuestruara për periudhën 16 shtator 2012 – 27 shkurt 2013.

Lloji	Nr.Raste	Zbuluar	Sasia	Autorë	Arr/Ndal	Gj.Lirë	Kërkim
Heroinë	40	40	36 kg 457.5 gr	53	50	3	0
Fenterminë	1	1	1.2 gr	1	0	1	0
Kokainë	14	13	1 kg 707.3 gr	13	12	1	0
Marijuanë	429	402	12637 kg 839.8 gr	537	350	158	29
Hashish	1	1	431.6 gr	2	2	0	0
Fara Kanabis	0	0	3.8 gr	0	0	0	0
Fara Papaver	1	1	288.9 gr	1	1	0	0
Përzierës	2	2	168 kg 480.1	2	2	0	0
Totali	488	460		609	417	163	29

Gjatë periudhës 16 shtator 2013 – 27 shkurt 2014:

Janë kryer 27 operacione ku janë përdorur Teknikat Speciale Hetimore;
(21 janë kryer në të njëjtën periudhë të vitit 16 shtator 2012- 27 shkurt 2013).

Janë goditur 30 grupe kriminale të trafikut e shpërndarjes së lëndëve narkotike me 117 persona të proceduar penalisht.

(23 grupe me 102 persona janë goditur në të njëjtën periudhë të vitit 16 shtator 2012- 27 shkurt 2013).

Janë kryer 34 operacione, ku janë përdorur forma të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar ku janë arrestuar në vendin tonë 42 persona për trafik ndërkombëtar droge (31 me Italinë, 2 me Gjermaninë, 1 me Belgjikën). Vlejnë për t'u përmendur operacionet e përbashkëta me Italinë "Ellenika-AL", "Ellenika 2", ku janë arrestuar 6 persona dhe "Trust-AL", ku janë arrestuar 3 persona për trafik ndërkombëtar narkotikësh dhe ku janë sekuestruar sasi të konsiderueshme lënde narkotike në Shqipëri dhe në Itali.

(21 operacione ndërkombëtare me 26 persona të arrestuar janë kryer në të njëjtën periudhë të vitit 16 shtator 2012- 27 shkurt 2013).

- Trafikët e paligjshme

Gjatë vitit 2013, Sektori për Trafikun e Paligjshëm ka ndjekur dinamikën e ngjarjeve dhe realizimin e detyrave të planifikuara. Prioritet i punës ka qenë parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, adresimi në trafikimin e brendshëm dhe trafikimin e të miturve. Rritja e numrit të hetimeve proaktive dhe identifikimi i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.


Të dhëna krahasuese 16 shtator – 27 shkurt

Për periudhën raportuese 16 shtator 2013 deri më 27 shkurt 2014, nga Sektori për Trafikun e Paligjshëm në qendër dhe në bazë, janë evidentuar 242 vepra penale në gjithë vendin prej të cilave:

Vepa Penale	Evidentuar	Autorë	Arrestuar	Gj.Lirë	Kërkim	Ndaluar
Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve	16	30	14	11	4	1
Shfrytëzim prostitucioni	26	33	6	25	-	2
Trafikim i mjeteve motorike	148	154	2	148	2	2
Trafikim i armëve e municioneve	12	25	14	10	1	-
Trafikim i femrave	8	5	-	4	1	-
Trafikim i të miturve	4	4	-	2	2	-
Trafikim i personave	17	20	3	11	6	-
Trafikim i veprave të artit e kulturës	11	14	8	5	1	-
SHUMA	242	285	47	216	17	5

Nga strukturat për trafikun e paligjshëm gjatë periudhës 16 shtator 2013 – 27 shkurt 2014 krahasuar me periudhën 16 shtator 2012 - 27 shkurt 2013:

- Është rritur forca goditëse e strukturave të policisë, ku janë evidentuar 64 vepra penale në fushën e trafikëve të paligjshme më tepër.
- Është rritur numri i autorëve të proceduar me 92 persona më tepër.
-



Operacionet Policore

Për periudhën 16.09.2013 -27.02.2014, janë realizuar 18 operacione policore me 75 autorë nga të cilët 38 janë arrestuar/ndaluar, 33 procedohen në gjendje të lirë dhe 4 janë shpallur në kërkim.

Gjatë të njëjtës periudhë të një viti më parë, 16.09.2012 - 27.02.2013, janë realizuar 18 operacione policore me 81 autorë, nga të cilët 66 janë arrestuar/ndaluar dhe 15 procedohen në gjendje të lirë.

Grupet kriminale:

Për periudhën 16 shtator 2013 deri më 27 shkurt 2014 janë goditur 5 grupe kriminale me 20 autorë, nga të cilët 19 janë arrestuar dhe 1 është shpallur në kërkim konkretisht:

- 2 grupe kriminale me 7 autorë për veprën penale “Trafikimi i armëve dhe municioneve;
- 2 grupe kriminale me 6 autorë për veprën penale “Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufijve”;
- 1 grup kriminal me 7 autorë për pjesëmarrjes në organizatë kriminale, shfrytëzimit të prostitucionit dhe trafikimit të lëndëve narkotike.

Për periudhën 16 shtator 2012 deri më 27 shkurt 2013, janë goditur 4 grupe kriminale me 23 autorë të cilët janë arrestuar konkretisht:

- 3 grupe kriminale për veprat penale shfrytëzim prostitucioni, shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese, mbajtje e lokaleve për prostitucion;
- 1 grup kriminal për veprën penale “Trafikimi i armëve dhe municioneve”.

- Hetimi i aseteve kriminale

Lufta kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet kryesore të veprimtarisë së Policisë së Shtetit.

Veprimtaria e strukturave të hetimit të aseteve kriminale për periudhën në raportim ka pasur këta tregues:

Zhvillimi i kapaciteteve të brendshme:

- Në periudhën në raportim strukturat për hetimin e aseteve kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit kanë zhvilluar 3 trajnime, në të cilat kanë marrë pjesë 31 punonjës policie.
- Kanë filluar procedurat e prokurimit për blerjen e disa pajisjeve që do të mundësojnë krijimin e kushteve optimale në punën e strukturave për hetimin e aseteve kriminale. Këto pajisje do të blihen nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimit ligjor, dhënë nga Ministria e Financave në vlerën 14.000.000 lekë.
- Është miratuar Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 667, datë 20.12.2013, "Për përmirësimin e punës në drejtim të hetimit të aseteve kriminale". Nëpërmjet këtij urdhri, është miratuar dhe regjistri për evidentimin e praktikave të verifikimit dhe referimit për fillimin e procedimit pasuror.

Rritja e numrit të hetimeve të aseteve kriminale, e finalizuar me rritjen e numrit të sekuestrimeve dhe konfiskimeve si më poshtë:

Referimet për fillimin e procedimeve pasurore;

Si rezultat i punës së bërë mbi verifikimet pasurore, gjatë periudhës 16 shtator 2013 – 28 shkurt 2014, nga strukturat e Policisë së Shtetit janë referuar në Prokurorinë për Krime të Rënda 36 materiale për fillimin e procedimit pasuror me 41 subjekte. Në të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë referuar 29 materiale me 29 subjekte në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

Sekuestrimet, konfiskimet e pasurive

Në drejtim të sekuestrimit dhe konfiskimit, janë dhënë dy vendime për sekuestro nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe një vendim për konfiskim nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda.

Janë sekuestruar:

- a. Shtatë pasuri të paluajtshme në qytetin e Durrësit;
- b. Katër Llogari Bankare;

Janë konfiskuar 3 llogari bankare:

Rritja e bashkëpunimit me Prokurorinë për Krime të Rënda dhe struktura të tjera, të cilat marrin detyrime nga ligji.

Përmbushja e këtij objekti është përqëndruar kryesisht në identifikimin e pasurive që burojnë nga aktivitetet kriminale subjekt të ligjit, referimin për fillimin e procedimeve pasurore me qëllim sekuestrimin dhe konfiskimin e tyre, si dhe kryerjen e detyrave të urdhëruara nga Prokurorët përkatës.

Bashkëpunimi me Prokurorinë për Krimet e Rënda ka qenë i vazhdueshëm dhe në nivele të kënaqshme. Muajt e fundit të vitit 2013 janë intensifikuar analizat e përbashkëta me Prokurorinë për Krimet e Rënda për raste konkrete. Kjo praktikë ka rezultuar shumë e frytshme pasi vetëm në muajin janar 2014, si rezultat i këtij bashkëpunimi, janë sekuestruar 7 pasuri të paluajtshme dhe 2 llogari bankare.

- Pastrimi i Parave:


Gjatë periudhës shtator 2013 – 27 shkurt 2014, në total janë evidentuar 73 vepra penale me 93 autorë të implikuar, të ndjekur në gjendje të lirë:

- Për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, janë evidentuar 43 vepra penale me 58 autorë, të cilët ndiqen në gjendje të lirë. Nga këto, 29 janë me informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe 14 janë me indicje policore.
- Për veprën penale “Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë financiare”, janë evidentuar 30 vepra penale me 35 autorë, të cilët ndiqen në gjendje të lirë.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë evidentuar 10 vepra penale më shumë, 1 autor i proceduar më shumë.

Në total për periudhën shtator 2012 – shkurt 2013, janë evidentuar 63 vepra penale, 92 autorë, 5 të arrestuar, 87 në gjendje të lirë.

- Për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” janë evidentuar 40 vepra penale me 51 autorë, të cilët ndiqen në gjendje të lirë.
- Për veprën penale “Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë financiare”, janë evidentuar 23 vepra penale me 41 autorë, 5 të arrestuar, 36 në gjendje të lirë.



Siç shihet dhe nga grafiku i mësipërm, evidentimi i veprave penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, ka pasur një trend pozitiv nga viti në vit.

a) Operacione Policore.

Gjatë periudhës shtator 2013 - shkurt 2014, janë evidentuar: 6 autorë në gjendje të lirë në fushën e kambizmit për veprën penale “Ushtrim i palicensuar i veprimtarisë financiare”. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shtator 2012 – shkurt 2013, janë evidentuar 3 operacione policore më pak, me 6 autorë më pak dhe 2 të arrestuar më pak.

b) Sekuestrimet

Gjatë periudhës shtator 2013 – 27 shkurt 2014, janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale:

- Për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, neni 287 i Kodit Penal, shuma e sekuestruar është afërsisht 401.400 Euro;
- Për veprën penale “Ushtrim pa licencë i veprimtarisë financiare”, neni 170/ç i Kodit Penal sekuestrimet janë: 4.121.730 lekë, 29.920 Euro dhe 1.605 Dollarë.

Raste të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit Parave (DPPPP), me qëllim investigimin policor.

Gjatë periudhës shtator 2013 – 27 shkurt 2014, janë trajtuar gjithsej 178 raste të dërguara nga DPPPP si raporte të transaksioneve të dyshimta.

Gjatë periudhës shtator 2012 – 27 shkurt 2013, janë trajtuar gjithsej 70 raste të dërguara nga DPPPP si raporte të transaksioneve të dyshimta.

- Krimi ekonomik - financiar

Strukturat e Sektorit për Krimin Ekonomik e Financiar në shkallë vendi për periudhën 16 shtator 2013 - 27 shkurt 2014, kanë evidentuar në total 1.668 vepra penale, nga të cilat u zbuluan 1.631, me 1.732 autorë, prej të cilëve 95 të arrestuar dhe ndaluar dhe 1.625 të hetuar në gjendje të lirë dhe 11 në kërkim.

Të ndara sipas tendencave, më poshtë paraqiten veprat penale të evidentuara:

- Mashtrimi, evidentuar 234, zbuluar 231, me 225 autorë, nga të cilët 6 të arrestuar, 217 në gjendje të lirë dhe 2 në kërkim.
- Vepra penale në shoqëritë tregtare, evidentuar 6, zbuluar 6, me 6 autorë në gjendje të lirë.
- Kondrabanda, evidentuar 103, zbuluar 101, me 129 autorë, nga të cilët të arrestuar 47, në gjendje të lirë 77 dhe 5 në kërkim.
- Vepra penale në fushën e tatim - taksave, evidentuar 193, zbuluar 192, me 203 autorë, nga të cilët 6 janë të arrestuar dhe 197 të hetuar në gjendje të lirë.
- Falsifikim monedhash, evidentuar 24, zbuluar 11, me 20 autorë, 11 të arrestuar, 8 në gjendje të lirë dhe 1 në kërkim.
- Falsifikim dokumentesh, evidentuar 177, zbuluar 169, me 212 autorë, 25 të arrestuar, 180 në gjendje të lirë dhe 7 në kërkim.

- Zhvillim i palejuar i lojërave të fatit evidentuar 902, zbuluar 893, me 901 autorë të hetuar në gjendje të lirë.
- Vjedhje me shpërdorim detyre, evidentuar 15, zbuluar 15, me 22 autorë, arrestuar 1 dhe 21 në gjendje të lirë.
- Prodhim i kundraligjshëm, evidentuar 3, zbuluar 2, me 2 autorë, 1 i arrestuar dhe 1 në gjendje të lirë.
- Shkelje e së drejtës së pronësisë industriale evidentuar 11, zbuluar 11, me 11 autorë në gjendje të lirë.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, rezulton se u evidentuan 767 vepra dhe 708 autorë më shumë, ndërsa numri i personave të arrestuar është 27 më shumë, pasi në periudhën shtator 2012- shkurt 2013, ishin evidentuar 901 vepra penale, zbuluar 883, me 1024 autorë, prej të cilëve 68 të arrestuar, 952 në gjendje të lirë dhe 4 në kërkim.

a) Grupe kriminale

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 10 grupe, me 63 autorë, nga të cilët 50 të arrestuar, 5 në gjendje të lirë dhe 8 të shpallur në kërkim. Në krahasim me të njëjtën periudhë, u goditën 2 grupe dhe 6 autorë më shumë.

Grupet e evidentuara sipas drejtimeve janë:

- Për falsifikim monedhash 2 grupe, me 9 autorë, 8 të arrestuar dhe 1 në kërkim;
- Për falsifikim dokumentesh 2 grupe me 19 autorë, 17 të arrestuar, 2 në kërkim;
- Për kondrabandë 3 grupe, me 19 autorë, nga të cilët 14 të arrestuar (5 prej të cilëve doganierë) dhe 5 në gjendje të lirë;
- Në fushën e naftës, 1 rast me 5 autorë të arrestuar;
- Në fushën e tatimeve 2 grupe, me 11 autorë, 6 të arrestuar dhe 5 në kërkim.

b) Operacione policore

Nga strukturat e Sektorit për Krimin Ekonomik e Financiar, gjatë kësaj periudhe, janë realizuar 18 operacione policore, nga të cilat veçojmë:

1. Operacionin policor "Fund Marrëzisë", për goditjen e aktivitetit të kundërligjshëm të lojërave të fatit, ku u evidentuan në total 720 vepra penale për "Zhvillim i palejuar i lojërave të fatit", me 714 autorë të kallëzuar për ndjekje penale në gjendje të lirë, dhe u sekuestruan 3.710 pajisje të lojërave të fatit dhe 291 kompjuterë e 718 televizorë në pikat e basteve.

2. Operacionin policor "Stop Pirateria Televizive", zhvilluar gjatë muajve dhjetor 2013 - janar 2014, ku u proceduan penalisht "Për veprën penale shkelja e të drejtave të pronësisë industriale" 21 subjekte, pasi transmetonin në mënyrë të jashtëligjshme programet televizive të Kompanisë Digitalb, nëpërmjet rrjeteve kabllore. Gjatë këtij operacioni, u sekuestruan dhjetra pajisje televizive transmetuese, aparate "digitalb", antena satelitore etj.

3. Operacionin ndërkombëtar “Mërkuri i Bardhë 1” dhe “Mërkuri i Bardhë 2”, për goditjen e aktivitetit të tregtimit, prodhimit dhe mbajtjes së mallrave të falsifikuara, organizuar nga INTERPOL-i, në bashkëpunim me disa vende të Ballkanit dhe nën mbështetjen e Komisionit Evropian - TAIEK, zhvilluar nga datat 30 shtator – 06 tetor 2013, dhe 28 tetor 2013 – 3 nëntor 2013, ku u evidentuan në total 25 vepra penale në fushën e shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale, me 25 autorë, prej të cilëve 2 të arrestuar në flagrancë dhe 23 të proceduar penalisht në gjendje të lirë, si dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale një sasi e konsiderueshme produktesh të falsifikuara.

c) Iniciativa për kryerjen e ndryshimeve ligjore;


Me VKM Nr. 988, datë 8.11.2013, “Për miratimin e planit të veprimit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”, janë përcaktuar detyrat si vijon:

“Të shqyrtohet Kodi i Procedurës Penale, ligji për Policinë e Shtetit dhe ligji për komunikimet elektronike, me qëllim që hetimet të kryhen pa probleme (përfshi përmes përgjimit) dhe të dhënat të merren pa vonesa nga autoritetet kombëtare dhe operatorët telefonikë. Rivlerësimi dhe rishikimi i Memorandumeve ekzistuese të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhjetor 2013”.

“Analizim i ligjit për komunikimet elektronike në lidhje me përmbushjen e kërkesës për lehtësimin e hetimeve, duke përfshirë dhënien e propozimeve për ndryshime ligjore nëse janë të nevojshme”. Institucionet përgjegjëse janë Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë, dhjetor 2013”.

- Indikatorët kundër krimeve kompjuterike

Në fushën e krimeve kompjuterike është ruajtur trendi pozitiv i treguesve. Janë evidentuar 108 vepra penale ose 25 vepra penale më shumë se në vitin 2012. Gjatë vitit 2013 janë evidentuar 108 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 63 ose 58.3%, me 69 autorë, nga të cilët 58 në gjendje të lirë, 9 arrestuar dhe 2 në kërkim. Krahësuar me vitin 2012 janë evidentuar 25 vepra penale më shumë, me 2 autorë më pak, 4 të arrestuar në flagrancë më shumë.



Për veprën penale të krimeve kompjuterike, janë kryer 4 operacione ose 2 më shumë se vitin e kaluar.

Është parashikuar rikompozimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të kësaj strukture për vitin 2014, duke reflektuar dhe sugjerimet e Komisionit Evropian.

- Trajnimi dhe Shkollimi Policor

Aktivitetet shkolluese dhe trajnuese të zhvilluara në përfitim të strukturave të Policisë së Shtetit për periudhën janar – dhjetor 2013, janë si më poshtë;

Shkollimi bazë policor

1. Shkollimi Bazë Policor (Pjesa Teorike)

Shkollimi Bazë Policor – Teori (11 javor)

Për vitin 2013, në Qendrën për Formimin Policor (QFP) kanë përfunduar 3 kurse të Shkollimit Bazë Policor. Kursi 21-23 (11 javor), ku ishin të planifikuar për të marrë pjesë 411 punonjës policie dhe u certifikuan 314 prej tyre.

Trajnimi në terren

1. Kurs për trajnimin në terren kursi XIX dhe XXI (11 Javor):

Për periudhën janar – dhjetor 2013, në trajnimin në terren kanë marrë pjesë 576 punonjës policie prej të cilëve 569 të certifikuar. Nuk janë certifikuar për arsye të ndryshme 7 punonjës policie.

2. Kurs për trajnimin në terren. Kursi VII (22 Javor):

Gjatë periudhës 19 Shtator 2012 – 22 shkurt 2013, janë përfshirë në trajnim 193 punonjës policie të Kursit VII, 22 javor, në të cilin janë certifikuar 189 punonjës policie.

Trajnime të specializuara dhe të avancuara

1. Kurs për formimin e instruktorëve.

Në muajin maj 2013, është zhvilluar një kurs për trajnimin e instruktorëve në Policinë e Shtetit, të organizuar nga Departamenti për Trajnimin Policor dhe zhvilluar në Qendrën e Formimit Policor, në të cilën u certifikuan 14 punonjës policie.

2. Kurs për formim instruktori për Qentë e Policisë.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2013 kanë përfunduar 6 kurse trajnimi për formimin e instruktorëve të qenve të policisë, në të cilën janë certifikuar 13 punonjës të policisë.

Trajnime të avancuara

Trajnime të specializuara/avancuara sipas përfituesve:

Në Planin Vjetor të trajnimeve për vitin 2013, u planifikuan 139 trajnime/shkollime, dhe gjatë vitit u planifikuan edhe 158 shtesa trajnime të tjera të kërkuara nga donatorë të ndryshëm si dhe vetë Policia e Shtetit. Gjithsej u planifikuan 297 trajnime/shkollime dhe u realizuan 273 trajnime/shkollime (148 trajnime realizuar nga donatorët) prej të cilëve:

265 trajnime të specializuara/avancuara prej të cilave:

- 5 kurse për ngritje në gradë dhe shkollim për nivel me 120 të certifikuar.
- 8 trajnime të specializuara me 41 të certifikuar.
- 253 trajnime të avancuara me 3315 të certifikuar


3 kurse të Shkollimit Bazë Policor (11 javor);

4 kurse të Trajnimit në Terren (3 kurse 11 javore dhe 1 kurs 22 javor);

Trajnime sipas strukturave përfituese:

Nr.	Departamentet	Kurse	Planifikuar	Certifikuar
1.	DHK	99	1148	1036
2.	DKM	56	765	731
3.	DSP	33	660	510
4.	DTP	10	128	111
5.	DSHM	15	212	204
6.	QPMDH	2	17	17
7.	DBKN	1	1	1
8.	DST	4	38	38
	DPP	45	929	828
	SHUMA	265	3898	3476

Grafiku i trajnimeve sipas strukturave përfituese për periudhën janar – dhjetor 2013.



Kurse trajnimi të ofruara/financuara nga donatorët:

Për periudhën janar – dhjetor 2013, nga donatorët janë kryer 148 kurse trajnimi, ku janë certifikuar 1.547 pjesëmarrës.

Tabela e trajnimeve të realizuara nga donatorët sipas strukturave përfituese.

Nr.	Departamentet	Kurse	Certifikuar
1.	Hetimi i krimeve	59	543
2.	Kufiri dhe Migracioni	30	332
3.	Siguria Publike	15	211
4.	Trajnimi Policor	4	30
5.	Shërbimet Mbështetëse	5	12
6.	Mbrojtja e të Dhënave	1	10
7.	Bashkëpunimi Ndërkombëtar	1	1
8.	Standardet Profesionale	3	14
9.	Struktura të tjera të policisë	30	394
	SHUMA	148	1547

Trajnime të përbashkëta

Gjatë vitit 2013, në Policinë e Shtetit janë realizuar 54 trajnime të përbashkëta me 366 punonjës policie të certifikuar, më konkretisht:

- 29 trajnime me Prokurorinë e Përgjithshme, në të cilën janë certifikuar 188 punonjës policie nga strukturat e hetimit të krimeve;
- 12 trajnime rajonale dhe ndërkombëtare me pjesëmarrjen e 69 punonjësve të policisë nga strukturat e Hetimit të Krimeve dhe Kufirit dhe Migracionit;
- 1 trajnim me Doganat, me pjesëmarrjen e 15 punonjësve të Kufirit dhe Migracionit;
- 2 trajnime me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm me pjesëmarrjen e 10 punonjësve të policisë nga Strukturat e Drejtorisë së Standardeve;
- 1 trajnim me Kontrollin e Lartë të Shtetit me pjesëmarrjen e 6 punonjësve të Hetimit;
- 9 trajnime të përbashkëta me institucione të tjera shqiptare me 78 punonjës policie të certifikuar.

Trajnime jashtë vendit

Gjatë vitit 2013, janë realizuar 33 trajnime jashtë shtetit me pjesëmarrjen e 172 punonjësve të policisë të organizuara/financuar kryesisht nga ICITAP, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, OSBE, TAIEX, TIKA, Qeveria Gjermane, Qeveria Greke, INTERPOL, etj.

Seminare të realizuara

Gjatë vitit 2013 janë realizuar edhe 37 seminare në të cilat kanë marrë pjesë 1.500 punonjës policie.

- a) Nga strukturat e Kufirit dhe Migracionit janë realizuar seminare njëditore (7 orë) me temë: "Njohja dhe përdorimi i pajisjeve të kontrollit që përdoren në PKK" në disa Pika të Kontroll Kufitar;
- b) Nga strukturat e Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë është realizuar seminari njëditor me temë "Zhvillimi i olimpiadës rajonale për qentë dhe shoqëruesit sipas programit të miratuar nga Drejtoria e Arsimit Policor";
- c) Seminar për teknikat e menaxhimit të performancës me 35 pjesëmarrës, organizuar nga Agjencia e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ndërkombëtar Suedez (SIDA), më 03.10.2013.

Trajnimet për zgjedhjet

Në kuadër të trajnimit të punonjësve të policisë për procesin zgjedhor, për trajnimin me temë "Detyrat e Policisë së Shtetit gjatë procesit zgjedhor", janë trajnuar gjithsej 5.810 punonjës policie të strukturave vendore në Drejtoritë e Policive në Qarqe dhe Drejtoritë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin.

- Shkollimi për nivel dhe ngritje në gradë


Për vitin 2013, janë zhvilluar 5 kurse për ngritje në gradë, me 120 të certifikuar, prej të cilëve:

- | | |
|--|----------------------|
| - 1 trajnim për gradën nënkomisar | me 61 të certifikuar |
| - 1 trajnim për gradën kryekomisar | me 35 të certifikuar |
| - 2 trajnime për gradën drejtues | me 23 të certifikuar |
| - 1 trajnim për gradën drejtues i parë | me 1 të certifikuar |

Në total, gjatë periudhës janar – dhjetor 2013, janë certifikuar 10.508 punonjës policie të përfshirë në 311 kurse trajnime specializuar/avancuar, shkollime, seminare dhe trajnime për zgjedhje. Gjatë vitit 2013, janë trajnuar 4.450 punonjës policie më shumë se në vitin 2012.

Në tetor 2013, përfundoi Shkolla Bazë e Policisë për punonjësit e policisë në detyrë (11 javor), në të cilën u certifikuan 5.905 punonjës policie të rolit bazë.

Grafiku i trajnimeve/shkollimeve të zhvilluara për periudhën janar – dhjetor 2013.



Sipas Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, më datë 31 dhjetor 2013, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Qendrës Psiko-Sociale për “Rritjen e kapaciteteve të policisë në nivel lokal, mbi njohjen e të drejtave të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”. Gjatë vitit 2013 janë kryer 11 aktivitete trajnuese në fushën e trafikeve të paligjshme me 117 përfitues.

Për sa i përket Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, ajo zbatohet nëpërmjet një qasjeje holistike dhe ndërdisiplinore. Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2011-2013”, si dhe “Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit 2011-2013”, janë hartuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, në konsulencë me agjencitë shtetërore, ndërkombëtare dhe OJF-të. Njësia Antitrafik menaxhoi një proces të gjatë dhe ekstensiv të hartimit të strategjisë. I njëjti proces i gjerë konsultimi do të ndodhë edhe me hartimin e strategjisë së re.

Më poshtë paraqiten ndryshimet e fundit të Kodit Penal, Ligji Nr. 144, datë 2.05.2013, me anë të të cilave është zgjidhur çështja e:

- trafikimit të brendshëm;
- mosdënimit të viktimave të trafikimit;
- dënimit të personave që përfitojnë nga shërbimet e viktimave të trafikimit;
- dënimit të veprimeve që lehtësojnë trafikimin;

- shkrirjes së dispozitave të shfrytëzimit për prostitucion dhe shfrytëzimit për prostitucion në rrethana rënduese².

Koordinatori Kombëtar Antitrafik (KKA) ka propozuar ngritjen e një Task-Force mes Zyrës së Prokurorit për Krime të Rënda, Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe Policisë së Shtetit, me qëllim forcimin e bashkëpunimit mes këtyre agjencive dhe diskutimin e rasteve konkrete të trafikimit të personave. Për këtë qëllim, më 19 dhjetor KKA organizoi një takim me kryetarët e institucioneve të lartpërmendura, për të diskutuar mbi mënyrat e ngritjes së Task-Forcës, e cila do të forcojë bashkëpunimin dhe do të japë rekomandimet përkatëse. Aktualisht, ZKKA po punon me ICITAP-in mbi termat e referencës dhe shumë shpejt ky entitet do të ngrihet.

Më datë 23 janar 2014, në Tiranë, ZKKA me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri organizoi një konferencë mbi hetimin dhe gjykimin e çështjeve antitrafik. Kjo konferencë solli bashkautorët kryesorë nga strukturat e Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda, organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve aktive në këtë fushë.

Përkrah 6 trajnimeve të zhvilluara nga Policia e Shtetit dhe 6 të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, ZKKA mbështetur nga instrumenti i TAIEX-it, organizoi në datat 10-11 shkurt 2014, një trajnim mbi hetimin e trafikimit të fëmijëve dhe forcimin e mbrojtjes së fëmijëve. Në këtë trajnim morën pjesë 40 pjesëmarrës nga strukturat e Policisë së Shtetit, nga Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, organizatat e shoqërisë civile, Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik, etj. Gjithashtu, morën pjesë ekspertë nga vende anëtare të BE-së, si Franca, Italia, Spanja dhe Rumania.

Së fundmi, Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa për monitorimin e aktivitetit të tregut të punës dhe bizneseve. Më datë 12 nëntor 2013, KKA pati një takim me përfaqësues të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Drejtorisë të Policisë së Qarkut Tiranë për zhvillimin e planeve të përbashkëta të punës për ndërhyrje. Plani i punës u miratua nga palët e lartpërmendura, si dhe nga Drejtoria e Tatimeve në Ministrinë e Financave nën mbështetjen e Koordinatorës Kombëtare më datë 19 nëntor 2013.

Një zhvillim i rëndësishëm në vitin 2013 është edhe ngritja e tri Njësiave Lëvizëse (Tiranë, Vlorë dhe Elbasan), me qëllim identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit. Njësia Antitrafik ka qenë një promotor i fuqishëm dhe mbështetës i kësaj iniciative dhe aktualisht po punon për mbështetjen e vazhdimësisë dhe zgjerimit të këtyre 3 NJL-ve. Në muajin nëntor 2013, bashkëpunimi me Policinë e Shtetit është rritur me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes Drejtorive të Policive në Qarqe (Tiranë, Elbasan, Vlorë) dhe Njësiave Lëvizëse të lartpërmendura.

²Konkretisht janë ndryshuar dhe shtuar nenet 52/a; 110/a; 110/b; 110/c; 114 të KP.

Së bashku me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, KKA ka hartuar një plan veprimi mbi fenomenin e fëmijëve në situatë rruge. Ky dokument përmban veprime të qarta dhe konkrete si dhe afate. Ai do të formalizohet me një Marrëveshje Mirëkuptimi mes aktorëve të përfshirë.

Për periudhën janar - dhjetor 2013, 30 viktimat trafikimi kanë përfituar ndihmë ekonomike me një fond prej 1.080.000 lekë. Në programin e Mbrojtjes në projekt-buxhetin afat-mesëm 2013-2014 për produktin trafikimi i personave, është projektuar një fond prej 22.535.000 lekë.

Ky fond për operatorët jopublikë është 2.757.200 lekë. Fondi për paketat e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit është 780.000 lekë. Krahasimisht me vitin 2013, në vitin 2014 për Qendrat Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit, janë planifikuar 1.000.000 lekë më shumë dhe një fond për Ndihmën Ekonomike në masën 240.000 lekë më shumë se në vitin 2013.

Numri total i Viktimave të Trafikimit (VT)/Viktimave të Mundshme të Trafikimit (VMT) për vitin 2013 është 95, prej të cilëve 52 janë madhorë dhe 43 janë të mitur. 81 VT/VMT janë femra dhe 14 janë meshkuj. Gjatë vitit 2013, ka pasur vetëm 3 VT/VMT të huaja. Aktualisht, masat e mbrojtjes së veçantë (mbrojtje e dëshmitarit) janë zbatuar për 1 VT (femër).

Bashkëpunimi dhe koordinimi me shoqërinë civile duke pasur për qëllim krijimin e një Grupi Këshillimor të organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet e trafikimit, është një tjetër hap drejt rritjes së bashkëpunimit në nivel kombëtar. Së shpejti, KK do të organizojë takimin e radhës dhe do të formalizojë plotësisht Grupin Këshillimor, i cili do të kryejë vlerësime të pavarura dhe do t'i japë ZKKA-së rekomandime.

- Fushata ndërgjegjësimi
- Në kuadër të Ditës Evropiane kundër Trafikimit të Personave, më 19 tetor 2013, u organizua konferenca “Stop Trafikimit! Së bashku mund të bëjmë më shumë!” me pjesëmarrjen e zyrtarëve më të lartë në vend. Në konferencë u artikulua shumë qartë zotimi serioz i përpjekjeve kundër trafikimit në nivel kombëtar, duke mbështetur iniciativat e secilit aktor, në kuadër të axhendës së vendosur të prioritetëve.
- ZKKA, në bashkëpunim me strehëzën Vatra, ka prodhuar tri materiale, konkretisht: broshura, fletëpalosje dhe postera me moton “Pyet dhe informohu!”, të cilat shërbejnë për rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e trafikimit të personave. Ato targetojnë oficerët e policisë dhe viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit.
- ZKKA, në bashkëpunim të ngushtë me organizatën “Të ndryshëm & të barabartë”, kanë organizuar aktivitete të rritjes së ndërgjegjësimit në kuadër të projektit “Respekt për të drejtat e viktimave në Shqipëri – Fund stigmës!”, projekt ky i ndjekur në periudhën 2012-2013. Pjesë kryesore e këtyre aktiviteteve është fotonovela “Kjo është historia ime.”, histori e vërtetë e një

viktive trafikimi, e publikuar në 1.000 kopje, me qëllim ndërgjegjësimin mbi trafikimin e personave dhe stigmën e cila i shoqëron viktimat.

- Në 2 dhjetor 2013, Koordinatori Kombëtar Antitrafik organizoi një takim me studentë dhe pedagogë të Fakultetit të Shkencave Sociale mbi respektimin e të drejtave të viktimave të trafikimit me sloganin “Le të ndalojmë stigmën!”. Një takim i njëjtë informues u mbajt edhe në Fakultetin e Drejtësisë në muajin prill të vitit 2013.
- Më datë 19 tetor 2013, Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me organizatën “World Vision Albania” dhe “Fondacionin Vodafone Albania”, nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit mbi fillimin e projektit “Adresimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore me anë të zgjidhjeve të teknologjisë celulare”. Nëpërmjet këtij projekti, një aplikacion në *smartphone* “Raporto dhe Shpëto!” do synojë rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi çështjet e trafikimit të personave. Qëllimi i këtij aplikacioni është rritja e numrit të identifikimeve fillestare të viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe aksesit i shpejtë tek ndihma dhe informacioni.
- Për herë të parë në vitin 201
- 4, Njësia Antitrafik (NjAT) do të ketë buxhetin e saj në shumën 4.7 milionë lekë. Aktivitetet e parashikuara nën këtë buxhet do të synojnë parandalimin.

• Mbrojtja e të drejtave të njeriut

Për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave që shoqërohen, ndalohen dhe arrestohen në mjediset e policisë, janë zbatuar këto masa dhe detyra:

- VKM Nr. 158, datë 27.02.2013, “Për miratimin në parim të Protokollit për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”;
- Marrëveshje Bashkëpunimi mes Policisë së Shtetit dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit “Për përmirësimin e trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit”, datë 26.03.2013”.

Përmirësimi dhe krijimi i kushteve të përshtatshme në ambientet ku mbahen e trajtohen personat e privuar nga liria.

Për vitin 2013, me fondet e buxhetit të shtetit, është kryer realizimi i investimeve për rikonstruksionin e plotë të ambienteve të shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Tiranë dhe Komisariatin e Policisë Durrës. Ambientet e dhomave të shoqërimit dhe ato të sigurisë të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë janë vënë në funksionim në muajin janar 2013. Ambientet e Komisariatit të Policisë Durrës janë vënë në funksionim në muajin maj 2013.

Ndërtimi dhe funksionimi i këtyre ambienteve është bërë sipas kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare dhe përcaktimeve të bëra në Konventën për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore e Degraduese, të KE-së. Në

Informacioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për Komitetin e Stabilizim – Asociimit
këto ambiente janë vendosur/instaluar dhe funksionojnë sistemi i monitorimit dhe kontrollit me kamera.

Masat zbatuese afatmesme 2013 – 2015 për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave në ambientet e policisë:

1. Rikonstruksioni dhe krijimi i ambienteve të përshtatshme për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e personave të shoqëruar, arrestuar dhe të ndaluar në komisariatet e policisë Dibër dhe Elbasan, me fonde të Buxhetit të Shtetit, sipas planifikimeve në PBA.

Ky investim nuk është kryer gjatë vitit 2013, për shkak të kufizimeve buxhetore. Gjithsesi, nisur nga rëndësia që paraqet si prioritet, nga strukturat e mbështetjes logjistike do të shihet çdo mundësi për përfshirje të këtij investimi dhe më gjerë, në PBA-në 2014-2016, fillimisht nëpërmjet hartimit të studimit të fizibilitetit (projekt - zbatimit) dhe më pas nëpërmjet zbatimit të investimit.

2. Zbatimi i aktiviteteve për policimin dhe sigurinë në komunitet sipas projektit të financuar nga Qeveria Suedeze (Projekti SIDA).

Gjatë vitit 2013-2014, është ngritur Grupi i Punës, në përbërje të së cilit janë dhe strukturat e mbështetjes logjistike. Produkt i Grupit të Punës do të jetë dhe përmirësimi i ambienteve të shërbimit ndaj komunitetit. Ky investim do të kryhet me asistencë të programit SIDA, i cili ka përcaktuar një shumë për përmirësimin e ambienteve të njësive të Drejtorisë së Qarkut të Tiranës. Aktualisht, është miratuar projekti që do të zbatohet në Komisaratin Nr. 2 dhe po punohet për hartimin e projekt-idesë për investimin e pritshëm në komisariatet e tjera në Tiranë. Ky projekt përbën një prioritet të veçantë për strukturat e Policisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përmbushje të procesit të integritetit dhe si i tillë po ndiqet me përparësi. Ky projekt do të ndiqet dhe nga investime të tjera nga Buxheti i Shtetit dhe donatorë të tjerë.

Zhvillimi i trajnimeve të personelit policor dhe i takimeve dhe seminareve në fushën e njohjes dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria.

- Më datë 28.02.2013, nga Avokati i Popullit është organizuar një takim me temë: “Roli i mjekëve, i punonjësve të Policisë së Shtetit dhe i institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për monitorimin dhe menaxhimin e grevave të urisë”. Në këtë takim nga Policia e Shtetit morën pjesë rreth 20 punonjës policie, përfaqësues nga Drejtoria e Rendit Publik dhe nga strukturat e Rendit Publik në qarqe.
- Përfaqësues të Drejtorisë së Rendit Publik dhe drejtues të strukturave vendore të rendit (rreth 45 punonjës policie) kanë marrë pjesë në seminarin e organizuar nga organizatat e shoqërisë civile si: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti Evropian i Tiranës dhe Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës. Këto seminare njëditore janë zhvilluar gjatë muajit dhjetor 2013, ku është bërë prezantimi i raporteve të vizitave dhe inspektimeve që janë kryer nga OJF-të në drejtoritë dhe komisariatet e policisë si dhe rekomandimet përkatëse.

Informacioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për Komitetin e Stabilizim – Asociimit

- Në datat 26 dhe 27 dhjetor 2013, në Qendrën e Formimit Policor është zhvilluar trajnim njëditor me dy grupe mësimore me nga 25 punonjës. Në këtë trajnim morën pjesë përgjegjësit e sektorëve të rendit në D.P.Qarqeve, personeli mjekësor dhe ai i psikologut të D.P.Qarqeve si dhe përgjegjësit e dhomave të sigurisë të komisariateve të policisë.

Tematika e këtij trajnimi ka qenë: “Garancitë që ofron legjislacioni shqiptar dhe ai policor për trajtimin shëndetësor dhe psikologjik të të ndaluarve/arrestuarve në ambientet e policisë”.

Ky trajnim u organizua dhe u zhvillua nga Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës (QSHRT) në bashkëpunim me strukturat e Departamentit të Sigurisë Publike.

Rritja e transparencës së punës së Policisë së Shtetit dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e njeriut.

Për vitin 2013, janë hartuar dhe nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa OJF, si:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Policisë së Shtetit dhe Institutit Evropian të Tiranës me Nr. 1627, datë 25.03.2013, dhe Nr. 27, datë 25.03.2013, “Për përmirësimin e trajnimit dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit”.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Policisë së Shtetit dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit me Nr. 1626, datë 25.03.2013, dhe Nr. 68, datë 26.03.2013, “Për përmirësimin e trajnimit dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit”.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Nr. 106, datë 26.06.2013, dhe Nr. 3512, datë 08.07.2013, “Për parandalimin e torturës, keqtrajtimeve dhe rritjen e nivelit të respektimit të lirive dhe të drejtave të personave që privohen nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit”.

Përfaqësuesit e këtyre OJF-ve janë pajisur me leje provizore hyrjeje për të inspektuar e monitoruar ambientet e dhomave të sigurisë dhe ato të shoqërimit për respektimin e të drejtave të këtyre personave, si më poshtë:

- 27 punonjës nga të KShH-së;
- 6 punonjës nga “Të drejtat e Njeriut në Demokraci”;
- 8 punonjës nga QSHRT-ja.

Njohja dhe zbatimi i raporteve dhe rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit dhe OJF-të.

Raportet dhe rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe OJF-të, u janë bërë të njohura strukturave vendore të policisë. Po kështu, u janë përcaktuar dhe

detyrat që do të kryejnë për përmirësimin e trajtimit dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë.

Informacioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për Komitetin e Stabilizim – Asociimit
Janë përgatitur dhe dërguar në drejtoritë dhe komisariatet e policisë aktet e mëposhtme administrative të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit:

- Tërheqje vëmendje Nr. 8276, datë 02.2012.2013, “Për rishikimin e masave të sigurisë dhe përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave të arrestuar/ndaluar, në ambientet e policisë”.
- Tërheqje vëmendje Nr. 7946/1, datë 25.11.2013, “Për parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve/qëndrimeve që çenojnë dinjitetin e individit për shkak të etnisë”.

Në këtë tërheqje vëmendjeje, vihet theksi në trajtimin e njëllotë, pa diskriminim dhe të barabartë të të gjithë shtetasve, sipas përcaktimeve të nenit 18 të Kushtetutës, vlerësimin dhe trajtimin e të gjitha ankesave, denoncimeve të bëra për keqtrajtime/abuzime apo shkelje të të drejtave të personave, si dhe marrjen e masave disiplinore ndaj personelit policor përgjegjës.

- Tërheqje vëmendjeje Nr. 9045, datë 31.12.2013, “Për hedhjen dhe pasqyrimin e të dhënave për personat e shoqëruar, arrestuar dhe të ndaluar në sistemin elektronik ADAM”.

Zhvillimi i diversitetit dhe barazisë gjinore në Policinë e Shtetit

Policia e Shtetit është e angazhuar intensivisht në krijimin e mundësive të barabarta të përfaqësimit për të gjitha grupet shoqërore që reflektojnë komunitetin të cilit ajo i shërben. Përkrahja dhe zbatimi i vlerave të diversitetit dhe barazisë gjinore në Policinë e Shtetit është sanksionuar në aktet e tjera ligjore, nënligjore dhe administrative. “Plani i veprimit mbi zhvillimin e diversitetit në policinë e shtetit, 2011-2013”, përfshin një objektiv për përfaqësimin e grave me gradë policore në masën 6-7%, të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, objektivi i cili tashmë është arritur. Në vitin 2013, femrat përfaqësonin 10.7 % të numrit të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit.

Për sa i përket strukturës institucionale në drejtim të çështjeve gjinore, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka në përbërjen e saj 4 specialistë për diversitetin, në nivel qendror, si dhe sektorë/seksione të posaçëm për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje (në nivel qendror dhe vendor), ku trajtohen të gjitha rastet e denoncuarra për dhunë në familje.

Lidhur me parandalimin dhe reagimin ndaj krimeve të dhunës me bazë gjinore, të cilat kërkojnë formim dhe procedura të posaçme, mund të themi se këto kërkesa realizohen nëpërmjet kurrikulave mësimore, akteve ligjore dhe nënligjore si dhe procedurave standarde për çështje të caktuara, ku janë të përfshira tema të ndryshme si:

- Kuptimi themelor për të drejtat e njeriut dhe përfshirja e policisë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Të drejtat e njeriut, të cilat lidhen me procedurat e arrestimit dhe paraburgimit;

Informacioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për Komitetin e Stabilizim – Asociimit

- Procedurat ligjore që duhet të zbatohet punonjësi i policisë për kontrollin e personave dhe të vendeve/banesave;
- Barazia gjinore dhe faktorët të cilët mund të krijojnë pabarazi mes gjinive.
- Trajtimi nga ana ligjore dhe morale i çështjeve specifike gjinore, si dhe për të mos lejuar diskriminimin gjatë punës për mbrojtjen e rendit e të sigurisë publike.
- “Ligji i Barazisë Gjinore”, çështjet gjinore.

Pjesë e kurrikulave mësimore janë edhe aktet ligjore dhe nënligjore si dhe procedurat standarde, të cilat trajtojnë tema të ndryshme si:

- Parimet e Policisë së Shtetit në lidhje me ngacmimin, racizmin, diskriminimin ndaj gjinisë apo përkatësisë etnike të çfarëdo lloji, procedurat informuese dhe veprimet e mundshme disiplinore;
- Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritja e shkallës së barazisë efektive dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve, siç parashikohet me ligj;
- Veprimet e punonjësve të policisë dhe reagimi i tyre ndaj telefonatave për dhunë familjare, duke përfshirë këtu detyrat e oficerit të policisë gjyqësore, vlerësimet lidhur me incidentin, veprimet që kryen në vendin e ngjarjes dhe përpilimin e raportit;
- Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, si dhe veprimet e tjera që kryen punonjësi i policisë në rastet e ndërhyrjes kundër dhunës në familje dhe për mbrojtjen e viktimës;
- Parimet e Policisë së Shtetit lidhur me ngacmimin dhe diskriminimin gjinor në vendin e punës.

Një ndër objektivat e përcaktuara qartë në Plan Veprimin mbi Zhvillimin e Diversitetit, (pika II, mbi hartimin dhe miratimin e politikave dhe procedurave për rritjen e shkallës së përfaqësimit të grave dhe vajzave në Polici), është që në vitin 2013, numri i punonjësve femra me gradë policore, të përbëjë rreth 6-7% të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit me grada policore. Ky objektiv është arritur, pasi përfaqësimi i femrave me gradë policore është 6 %.

Tabelat me të dhënat statistikore aktuale mbi përfaqësimin e femrave në polici (31.12. 2013)

VITI 2013	FEMRA		MESHKUJ	
Përfaqësimi	Nr.	Në %	Nr.	Në %
Me Gradë Policore	583	6.00 %	8315	85.30 %
Civil	456	4.70 %	397	4.10 %
Totali	1039	10.70%	8709	89.30 %

Informacioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për Komitetin e Stabilizim – Asociimit
 Policia e Shtetit bazuar në gjendjen aktuale në lidhje me barazinë gjinore dhe me përcaktimin e masave, me synim fuqizimin e rolit të gjinisë më pak të përfaqësuar, për të ardhmen ka këto objektiva:

- Rritja në vazhdim e numrit të personelit femëror, veçanërisht në strukturat ku prania e tyre është e rekomanduar dhe e domosdoshme, (parashikuar edhe në strategjitë përkatëse);
- Vazhdimi i aktiviteteve mbi fuqizimin e kapaciteteve të punonjësve të Policisë nëpërmjet trajnimeve dhe workshop-eve të ndryshme, në drejtim të mbështetjes së vlerave të diversitetit si dhe kundër dhunës në familje;
- Hartimi i politikave, marrja e masave konkrete dhe zhvillimi i aktiviteteve për promovimin dhe ngritjen në detyrë të personelit femëror në Policinë e Shtetit.
- Rishikimi dhe përmirësimi në vazhdim i kurrikulave nga strukturat arsimore të Policisë së Shtetit për temat që trajtojnë çështjet gjinore, në bashkëpunim me sektorët përkatës dhe OJF-të;
- Hartimi i mëtejshëm i politikave të posaçme për përfshirjen më të madhe të femrave në role operationale;
- Krijimi i ambienteve të posaçme për veshjen dhe ndërrimin e personelit mashkullor dhe femëror në vendin e punës;
- Ngritja dhe përfundimi i përshtatjes së ambienteve të shoqërimit e sigurisë, duke i ndarë më vete, për gratë, të miturit dhe të rriturit në Drejtoritë e Policisë në Qarqe, që janë ende në proces;
- Krijimi i kushteve lehtësuese në vendin e punës për prindërit me fëmijë të vegjël;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me OJF-të dhe institucione të specializuara për zhvillimin e anketimeve në komunitet me të dhëna të ndara sipas përkatësisë gjinore;
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse vendore për t'iu përgjigjur me masa ligjore çdo rasti të dhunës në familje, nëpërmjet grupeve multidisiplinore që duhet të ngrihen për këtë qëllim;
- Intensifikimi i fushatave sensibilizuese në bashkëpunim me aktorët përgjegjës, duke vlerësuar rolin e mediave në këtë drejtim.

6.4 TREGU I BRENDSHËM DHE KONKURRENCA

• Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale

Vepra penale	2012		2013		Diferenca v.penale
	Evidentuar	Autorë	Evidentuar	Autorë	
Neni 149/a dhe 288/a Kodi Penal	20	22	43	47	+215%

- Operacion kombëtar për goditjen e piraterisë televizive:

Gjatë muajve dhjetor 2013 - janar 2014, u zhvillua operacioni policor për goditjen e veprimtarisë së paligjshme të shkeljes së të drejtave televizive (pirateria televizive), ku u kontrolluan 36 subjekte transmetuese, dhe u proceduan penalisht

Informacioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për Komitetin e Stabilizim – Asociimit
për veprën penale "Shkelja e së drejtës së pronësisë industriale", parashikuar nga
neni 149/a, 21 subjekte me 20 autorë të proceduar penalisht në gjendje të lirë, pasi
transmetonin në mënyrë të paligjshme programe të kanaleve televizive të
subjektit "Digitalb".

Në funksion të përmirësimit të efikasitetit gjatë vitit 2013, janë zhvilluar 11
aktivitete trajnuese, të organizuara kryesisht nga instrumenti i TAIEX-it apo
INTERPOL-i, ku kanë përfituar 28 specialistë.